



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2023:242571  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05608072

Kom.Dh.Shk.II.nr.1642/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Ariani” Sh.p.k, me seli në Prishtinë , e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat K.B. me zyre në Gjakovë, kundër debitorit “First Story”, Sh.p.k, me nr. unik identifikues 811127150 me seli në Gjakovë, rr. “Washingtoni” p.n., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A S. me zyre në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.2437/22 të datës 27.09.2023, me datën 23.04.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Ariani” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.2437/22 të datës 27.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2437/22 të datës 27.09.2023, në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “First Story”, Sh.p.k, ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.521/22 i datës 07.10.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, sa i përket borxhit në shumën prej 3.500.00 EUR. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit “First Story”, Sh.p.k, ashtu që ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr.521/22 i datës 07.10.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi sa i përket borxhit në vlerë prej 1.400.00 EUR.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar i autorizuari i kreditorit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar ashtu që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit, është e pathemeltë.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit përmbartimor P.nr. 388/2022 i datës 14.09.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve: Fatura nr. G/1-e e datës 01.01.2020, Fatura nr. G/2-e, e datës 01.02.2020, Fatura nr. G/3-e, e datës 01.03.2020, Fatura nr. G/4-e, e datës 01.04.2020, Fatura nr. G/5-e, e datës 01.04.2020, Fatura nr. G/5-e, e datës 01.05.2020, Fatura nr. G/6-e, e datës 01.06.2020, Fatura nr. G/7-e e datës 01.07.2020, duke urdhëruar debitorin që për faturat e lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 4.900,00 € (katërmijë e nëntëqind euro) me kamatë ligjore prej 8% si duke e llogaritur nga data 01.08.2020 e deri në përmbushjen defitnitive.

Kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit debitori ka paraqitur prapësim me të cilën ka kërkuar që të anulohet urdhri për përmbartim.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2437/22 të datës 27.09.2023, me të cilin në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit "First Story", Sh.p.k, ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.521/22 i datës 07.10.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, sa i përket borxhit në shumën prej 3.500.00 EUR. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit "First Story", Sh.p.k, ashtu që ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.521/22 i datës 07.10.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi sa i përket borxhit në vlerë prej 1.400.00 EUR.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbartimore. Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përmbartimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit vetëm

për shumën prej 3,500€, ndërkaq e ka refuzuar prapësimin për shumën e borxhit prej 1,400€, duke dhënë arsye të mjaftueshme në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ka konstatuar drejtë faktin se urdhri për lejimin e përmbartimit për pjesën e refuzuar të prapësimin nga pika II e dispozitivit të aktvendimit bazohet në faturat e rregullta të nënshkruara dhe të pranuar nga ana e debitorit. Ndërkaq, sa i përket pjesës së aprovuar të prapësimin të debitorit për shumën prej 3,500€, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se për këtë pjesë të borxhit, nga faturat të cilat shërbejnë si dokumente të besueshme nuk mund të evidentohet se debitori i ka pranuar në mënyrë të rregullt këto fatura për detyrimin e kërkuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lartcekura, të cilat përpos faturës G/1- e të datë 01.01.2020 dhe faturës g/2 – e të datës 01.02.2020, të cilat janë të pranuar nga debitori dhe se të njëjtat janë në origjinal, të pranuar dhe të nënshkruar nga debitori, faturat tjera nuk janë të pranuar nga debitori. Sa i përket faturave të pranuar, këto e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së dhe si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit.

Faturat që janë bazë për lejimin e përmbartimit i përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të nenit 29 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshkruar për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”* si dhe janë në pajtim me nenin 37 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Prandaj, bazuar në këto arsye, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të atakuar, mori parasysh pretendimet ankimore të kreditorit se debitori faturat i ka pranuar me postë, mirëpo vlerëson se qëndrimi i shkallës së parë është i drejtë kur ka konstatuar se në flete kthimin me rekomandë e Postës së Kosovës e datës 07.08.2020 nuk evidentohet fare lloji i dërgesës që kreditori ka dërguar për debitorin, por vetëm përshkrimi “Letrat”. Mbi këtë bazë, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka konstatuar se nuk mund të konsiderohet si i rregullt pranimi i faturave nga

ana e debitorit përderisa nuk ka prova përmes të cilave vërtetohet se debitori vërtetë është shërbyer me faturat e lartcekura përmes Postës së rregullt, dhe se të njëjtat fatura i ka pranuar duke mos kundërshtuar detyrimin që rrjedh nga kjo faturë.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së dytë  
Kom.Dh.shk.II.nr.1642/23, me datë 23.04.2024

Gjyqtari  
Dren Rogova